

NJË PËRQASJE ALTERNATIVE
PËR DEKOMPOZIMIN E
INFLACIONIT NË SHQIPËRI, NË
KONTRIBUTE TË BRENDSHME
DHE TË JASHTME NGA
MATRICA INPUT-OUTPUT

Enian Çela

2 (83) 2022 **AMBERAL SYNDICOR**



BANKA E SHQIPËRISË


**NJË PËRQASJE
ALTERNATIVE PËR
DEKOMPOZIMIN
E INFLACIONIT NË
SHQIPËRI, NË KONTRIBUTE
TË BRENDSHME DHE TË
JASHTME NGA MATRICA
INPUT-OUTPUT**

Enian Çela

2 (83) 2022

MATERIAL STUDIMOR

BANKA E SHQIPËRISË



Enian Çela

Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

E-mail: ecela@bankofalbania.org

***Shënim:** Mendimet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinione ose qëndrime të Bankës së Shqipërisë.*

© 2022 Banka e Shqipërisë

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	8
1. HYRJE	9
2. LITERATURA	12
3. METODOLOGJIA	15
4. REZULTATET	18
4.1 Hyrje	18
4.2 Bujqësia dhe industria ushqimore	18
4.3 Sektorë me çmime të rregulluar dhe pjesërisht të rregulluar	20
4.4 Sektorë të tjerë të industrisë përpunuese	22
4.4 Karburante	26
4.5 Shërbimet	27
4.6 Kontributet në nivel të agreguar dhe kontributi i brendshëm	29
4.7 Kontributet e inflacionit të importuar	31
4.8 Një dekompozim alternativ i presioneve të brendshme inflacioniste	36
5. PËRFUNDIME	41
6. DISKUTIME, IMPLIKIME DHE MUNDËSI KËRKIMORE NË TË ARDHMEN	43
BIBLIOGRAFI	47
SHTOJCA 1: GRUPIMET SEKTORIALE SIPAS STRUKTURËS INPUT-OUTPUT DHE INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT	49

GRAFIKË

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe norma e inflacionit në vite	9
Grafik 2. Deflatori vjetor i importeve	10
Grafik 3. Multiplikatorët e vlerës së shtuar dhe të importit sipas sektorëve ekonomikë	16
Grafik 4. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Bujqësi”	19
Grafik 5. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Industri ushqimore”	20
Grafik 6. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Furnizim me ujë dhe kanalizime”	21
Grafik 7. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Energji elektrike dhe gaz”	21
Grafik 8. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit të produkteve “Farmaceutike”	22
Grafik 9. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Tekstile dhe veshje”	23
Grafik 10. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Mobilje”	23
Grafik 11. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Makinëri”	24
Grafik 12. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit “Dru, letër dhe shërbime printimi”	25
Grafik 13. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit të produkteve “Plastike”	25
Grafik 14. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit të produkteve “Metalike”	26
Grafik 15. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit të “Karburateve”	27
Grafik 16. Kontributet e brendshme dhe të importuara në inflacionin e përgjithshëm të sektorit të “Shërbimeve”	28
Grafik 17. Dezagregimi i kontributeve të brendshme dhe të huaja në inflacionin total	29
Grafik 18. Kontributet e brendshme në inflacionin total sipas sektorëve	31
Grafik 19. Kontributi direkt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) në inflacionin e përgjithshëm	31
Grafik 20. Kontributi indirekt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve bartës të kostos në inflacionin e përgjithshëm	32
Grafik 21. Kontributi indirekt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve shkaktarë të kostos në inflacionin e përgjithshëm	33
Grafik 22. Kontributi i përgjithshëm i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve përgjegjës në inflacionin e përgjithshëm	34
Grafik 23. Kontributi sektorial neto në inflacionin e përgjithshëm	35
Grafik 24. Kontributi i brendshëm i dezagreguar në total	38
Grafik 25. Kontributi i brendshëm dhe i huaj në inflacion	40

TABELA

Tabela 1. Peshë e "Marzheve tregtare dhe të transportit" dhe "Taksave neto" në shportën konsumatore në përqindje 37

Tabela 2. Marzhi tregtar dhe i transportit sipas komponentëve përbërës 38

ABSTRAKT

Normat e inflacionit në Shqipëri gjatë dekadës së fundit kanë rezultuar përgjithësisht më të ulëta krahasuar me vitet 2000. Vlerësohet se fenomeni lidhet si me dobësitë ciklike që karakterizojnë ekonominë, ashtu edhe me praninë e normave përgjithësisht negative të inflacionit të importuar. Me fjalë të tjera, si mjedisi i brendshëm ashtu edhe ai i jashtëm kanë nxitur presione të ulëta (ose negative) në inflacionin e përgjithshëm. Materiali synon dekompozimin e këtyre presioneve për të kuptuar më mirë natyrën, çastet kur kanë ndikuar dhe në rastin e presioneve të huaja, ndryshimet në terma të përcimit të efekteve. Metoda përfshin një dekompozim sipas Tabelave Input-Output të vendit që mundësojnë identifikimin e ndikimeve në terma të mallrave dhe shërbimeve përfundimtare dhe në terma të inflacionit të kostove të prodhimit. Risia krahasuar me literaturën ekzistuese për vendin lidhet me dezagregimin e presioneve të importuara në direkte dhe indirekte (kanali i kostove). Rezultatet dëshmojnë se presionet e brendshme inflacioniste mbizotërojnë në formimin e inflacionit të përgjithshëm. Nga ana tjetër, presionet e huaja kanë dhënë ndikim në periudha të caktuara dhe në terma të diferencave të inflacionit. Kontributi i karburanteve vlerësohet mjaft i rëndësishëm në dinamikat inflacioniste për periudha të caktuara dhe veçanërisht përmes kanalit të kostove të prodhimit. Gjithashtu, një dekompozim i veçantë i impaktit të brendshëm zbulon rëndësinë që marzhet tregtare dhe taksat neto kanë në formimin e inflacionit.


Fjalë kyçe: **inflacion, struktura e kostos, dekompozim input-output.**
JEL: **E31, D24, C67.**

1. HYRJE

Normat inflacioniste në Shqipëri kanë shfaqur një tendencë përgjithësisht rënëse gjatë dekadës së kaluar. Normat e inflacionit shënonin një mesatare 3.2% gjatë viteve 2008-2011. Më pas, norma ka ardhur relativisht në ulje për të arritur minimumin prej 1.3% në vitin 2016. Gjatë fillimit të vitit 2016, u vunë re edhe disa muaj me vlera mjaft të ulëta inflacioni (pranë nivelit zero) që nxitën edhe një reagim të politikës monetare.

Vlerësohet që ndikimet në inflacion burojnë si nga presionet e brendshme, ashtu edhe nga ato të jashtme inflacioniste. Në frontin e brendshëm, normat e rritjes ekonomike kanë rezultuar dukshëm më të ulëta krahasuar me mesin dhe fundin e viteve 2000. Kjo ka nxitur një ecuri të ciklit ekonomik nën nivelin potencial me hendek negativ në zgjerim të prodhimit (dhe të papunësisë) (Çeliku, Çela, Metani, 2018). Ky fenomen vlerësohet të ketë pasur ndikim në presionet e brendshme inflacioniste dhe megjithëse hendeku i prodhimit (dhe papunësisë) ka ardhur në ngushtim, prania e kapaciteteve të lira tërheq përsëri për poshtë inflacionin.


Grafik 1. Rritja ekonomike dhe norma e inflacionit në vite



Burimi: INSTAT.

Për sa i përket ndikimeve nga mjedisi i jashtëm, statistikat dëshmojnë për norma të ulëta dhe shpeshherë negative të deflatorëve të importit. Fenomeni në fjalë është shkaktuar si nga normat e ulëta të çmimeve ndërkombëtare, ashtu edhe nga një tendencë e vazhdueshme e mbiçmimit të monedhës vendase. Në mënyrë të veçantë, mbiçmimi i kursit të këmbimit ka vazhduar për një periudhë relativisht të gjatë dhe është forcuar nga viti në vit duke qenë faktor në vlerat negative të deflatorëve të importit.

Grafik 2. Deflatori vjetor i importeve (%)



Burimi: Instat dhe llogaritje të autorit.

Si përfundim, si presionet e brendshme ashtu edhe presionet e huaja inflacioniste vlerësohet të kenë qenë faktorë përcaktues në uljen e normave të inflacionit në vend. Intensitetet mund të kenë qenë të ndryshme në kohë të ndryshme. Gjithashtu, faktorët e brendshëm mund të kenë ardhur në përmirësim si pasojë e përmirësimit të ciklit ekonomik gjatë dy viteve të fundit, ndërkohë që presionet e jashtme mbeten faktorë në tërheqjen për poshtë të normave inflacioniste duke pasur parasysh deflatorët e ulët.

Në këtë material paraqitet një metodologji e dekompozimit të inflacionit të përgjithshëm në terma të kontributeve të brendshme dhe të jashtme (të importuara) inflacioniste. Bazohet mbi një përfaqje kontabël sipas strukturës Input-Output. Dekompozimi zbatohet në terma tremujorë për periudhën 2014- 2020T2 (sipas disponibilitetit

të të dhënave) për kategoritë e dezagreguara të mallrave dhe në total për shërbimet. Presionet e jashtme inflacioniste ndahen më tej në terma të ndikimeve direkte (përmes mallrave dhe shërbimeve të importuara që ofrohen për konsumatorin) dhe ndikimeve indirekte (përmes kostove të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve). Vlerësimet në nivel mallrash dhe shërbimesh agregohen për të dhënë ndikimet në inflacionin e përgjithshëm të vendit. Në këtë mënyrë, metodologjia bashkon në një përfaqje të dy drejtimet prej nga impakti i importuar mund të burojë. Kjo shmang nevojën e supozimeve për "sektorë" tërësisht me ndikime të brendshme ose tërësisht me ndikime të jashtme.

Vlerësohet se presionet e brendshme inflacioniste kanë rezultuar mbizotëruese në formimin e inflacionit gjatë periudhës në analizë. Vihet re një zbehje e këtyre presioneve gjatë viteve 2015-2016, pasuar nga një zgjerim gjatë viteve 2017 dhe 2018, për t'u pakësuar përsëri në periudhën e fundit. Ndërkohë, presionet e huaja inflacioniste kanë rezultuar vazhdimisht negative dhe shpesh herë këto presione kanë qenë përcaktuese në ndryshimet e normave të inflacionit. Gjithashtu, vlerësohet që përcjellja e këtyre presioneve nuk ka qenë e njëjtë në kohë për kategori të caktuara gjë që ka pasur ndikim në inflacionin total. Përveç ndikimit direkt në shportë, vlerësohet që një pjesë e impaktit ka kaluar përmes kanalit të kostove të prodhimit, si në rastin e mallrave ashtu edhe në rastin e shërbimeve. Këtu mund të përmendet rasti i "karburanteve" si një element i rëndësishëm i kostos që ka dhënë ndikime të qenësishme në normën e inflacionit përmes kanalit indirekt.

Për sa i përket presioneve të brendshme inflacioniste, përmirësimi i vlerësuar gjatë vitit 2017 dhe fillimit të vitit 2018, mendohet të jetë ndikuar nga përmirësimi i marzheve tregtare dhe të transportit, si dhe kontributi i taksave neto. Ndërkohë, nuk vihet re ndonjë përmirësim i qenësishëm i kontributeve të vetë sektorëve të ekonomisë (me përjashtim të tremujorit të parë 2018, por edhe në këtë rast e lidhur me kategori të caktuara të çmimeve).

2. LITERATURA

Njohja e presioneve të brendshme dhe të huaja inflacioniste përbën një çështje tepër të rëndësishme për politikëbërjen ekonomike në tërësi dhe politikën monetare në veçanti (Bernanke, 2007). Me intensifikimin e proceseve globalizuese, edhe përçimi i çmimeve të huaja (përfshirë efektet e kursit të këmbimit) ka gjasa të jetë më i fortë (Auer, Levchenko, & Saure, 2017). Presionet e huaja inflacioniste mund të manifestohen si përmes kanalit direkt të mallrave dhe shërbimeve të importuara për konsum, ashtu edhe përmes kanalit të kostove (përmes inputeve të importuara) (McCarthy, 2000).

Dekompozimi kontabël i presioneve të brendshme dhe të huaja inflacioniste është një hershëm në literaturën empirike. Dekompozimi bazohet në nivelin e çmimeve të huaja dhe peshën e produktit të importuar në shportën e konsumit. Këtu mund të përmendet kontributi i Nordhau & Shoven (1977) për dekompozimin e presioneve të brendshme dhe të jashtme të Indeksit të Shitjes me Shumicë të Shteteve të Bashkuara gjatë periudhës 1965-1974. Shembuj më aktualë për impaktin e importeve nga vendet me paga të ulëta në inflacionin e Francës japin Carluccio, Gautier, & Guilloux-Nefussi (2018).

Përqasja sipas tabelave input-output në terma kombëtarë, rajonalë ose globalë po gjen një zbatim gjithnjë e më të gjerë në literaturën empirike. Arsyeja lidhet me faktin se këto statistika ofrojnë një pasqyrë shumë të qartë të ndërlidhjeve sektoriale në një ekonomi dhe mundësojnë identifikimin e kanaleve të përçimit të çmimeve (vendase ose të huaja) nga një sektor në tjetrin. Një tjetër përparësi krahasuar me një përqasje standarde kontabël, është se platforma lejon identifikimin e kontributeve të brendshme e të jashtme inflacioniste edhe në sektorë që mund të supozohen a priori si të paprekur nga një ndikim ose tjetri (siç është rasti i sektorit të të patregtueshmeve). Në këtë mënyrë, shmangen gabime që mund të lidhen me një identifikim të plotë të një sektori si të brendshëm ose të jashtëm, kur ndërkohë mund të ketë elemente të importuara ose vendase të bartura brenda strukturës së tij.

Teknika input-output ka gjetur zbatim të gjerë për kapjen e efekteve të brendshme dhe të huaja inflacioniste si në nivel të çmimeve të konsumit ashtu në terma të çmimeve të prodhimit. Auer, Levchenko, & Saure (2017) analizojnë përcimin e presioneve të huaja inflacioniste nga inputet në Indekset e Çmimeve të Prodhimit për disa vende të industrializuara në nivel multi-industrial. Përveç tabelave vendore, autorët përdorin edhe tabelat kufitare input-output (kur janë të disponueshme). Rezultatet dëshmojnë për një sinkronizim të normave të inflacionit të kostos nga një vend në tjetrin pikërisht për shkak të ekzistencës së kanalit të importit të inputeve që përcjohin si efektet e çmimeve ashtu edhe ato të kursit të këmbimit.

Struktura e përcimit të kostove përmes ndërlihdjeve input-output zbatohet nga Ahn, Park, & Chanho (2016) në një studim krahasues për Republikën e Koresë dhe disa vende evropiane. Në këtë rast, analiza sipas ndërlihdjes input-output kombinohet me një strukturë të Modelit të Korrigjimit të Gabimit që lejon identifikimin e përcimit të kostove në terma afatshkurtër dhe afatgjatë. Rezultatet dëshmojnë për një përcim rreth 70% në rastin e Koresë dhe pothuaj 100% në rastin e disa vendeve të përzgjedhura evropiane. Një tjetër shembull që lidhet me përcimin e presioneve të huaja (kursit të këmbimit) në rastin e kostove të prodhimit i përket rastit të Japonisë në nivel sektorësh industrialë (Hoang & Kiyotaka, 2016). Rezultatet dëshmojnë se rritja e intensitetit të inputeve të importuara zgjeron edhe shkallën e përcjelljes së presioneve të kursit të këmbimit. Shkalla e përcjelljes zgjerohet nëse sektori ekonomik pasqyron nivele të larta eksportesh.

Literatura empirike në lidhje me ndikimin e presioneve të jashtme inflacioniste në terma të komponentëve të çmimeve të kërkesës agregate (çmimeve të konsumit), merr parasysh ekzistencën e pranisë së mallrave përfundimtare për konsum ashtu edhe të mallrave për konsum të ndërmjetëm (Sharify, 2012). Përfaqsjë zbatohet mbi aplikimin e Modeleve Standarde të Çmimit sipas Leontief (Leontief Standard Price models) (Leontief, 1936) sipas të cilit presionet inflacioniste përcillen sipas kanalit të kostove dhe blerjeve përfundimtare njëkohësisht. Modeleve të tilla të modifikuara janë propozuar nga Levy (1985) dhe Sharify & Sancho (2011). Në shembujt empirikë të përdorimit të këtyre modeleve është rasti i

Ajakaiye & Ojowu (1994), të cilët e zbatojnë për rastin e Nigerisë. Gunluk-Senesen, Kaya, & Senesen (2018) zbatojnë një model të ngjashëm në sektorin e ndërtimit për rastin e Turqisë për të analizuar ndër të tjera impaktin e çmimeve të importit në të. Nga ana tjetër, Hara, Hiraki, & Ichise (2015) zbatojnë ndërlidhjet input-output (së bashku me metodologji të tjera), për të kuptuar nëse ka qenë zgjerimi i intensitetit importues, faktori pas rritjes së ndikimit të kursit të këmbimit në çmimet vendase në Japoni.

Literatura kontabël për dekompozimin e presioneve të huaja inflacioniste ka gjetur zbatim edhe në rastin e Shqipërisë. Këtu mund të përmenden rastet e Çeliku (2003) dhe Skufi & Çela (2017). Në të dy rastet, analiza zhvillohet në terma të grupeve dhe nëngrupeve sipas shportës konsumatore dhe nuk merren parasysh efektet indirekte të importit përmes kanalit të kostos. Ndër të tjera, vlerësohet që impakti indirekt përmes kanalit të kostos është i konsiderueshëm duke pasur parasysh intensitetin importues të vendit, veçanërisht në terma të mallrave të ndërmjetëm (Çela, 2016). Ajo që mungon në literaturën e vendit, është një përfaqje që përfshin të dy kanalet (atë direkt dhe atë indirekt) në një platformë të vetme duke mundësuar një dezagregim dhe identifikim më të qartë të secilit. Kjo do të shmangte edhe aplikimin e identifikimeve a priori (shpesh të gabuara) të një kategorie si tërësisht të brendshme ose tërësisht të jashtme.

3. METODOLOGJIA

Përqasja empirike synon dekompozimin e kontributeve të brendshme dhe të huaja në normat e përgjithshme dhe sektoriale të inflacionit. Dekompozimi realizohet sipas një baze kontabël duke u bazuar në tabelën input-output dhe tabelën burime-përdorime të vendit. Të dhënat mbështetëse përfshijnë Indekset e Çmimeve të Konsumit sipas shportës konsumatore, Indekset e Çmimeve të Importit dhe llogaritë kombëtare të Produktit të Brendshëm Bruto. Dekompozimi realizohet me bazë tremujore për periudhën 2014-2020T2. Objektivi është dezagregimi i presioneve të huaja në komponentin e tyre direkt dhe atë indirekt, duke paraqitur në këtë mënyrë edhe ndikimin e brendshëm sipas kategorive të shportës. Formula bazë e dekompozimit është sipas ekuacionit të mëposhtëm:


$$P_t = P_d * W_d + P_i * W_i \quad (\text{eq. 1})$$

Sipas ekuacionit 1, Indeksi i Çmimit të Konsumit sektorial (P_t) është në funksion të indeksit dhe peshës të produktit/shërbimit vendas (P_d dhe W_d respektivisht) dhe indeksit dhe peshës të produktit/shërbimit të importuar (P_i dhe W_i respektivisht). Kontributi i importuar ndahet më tej në kontribute direkte për mallrat dhe shërbimet e importuar që ofrohen drejtpërdrejtë në treg dhe ndikime indirekte të lidhura me blerjen nga sektorët ekonomikë të mallrave të ndërmjetëm (inpute në prodhim).

Tabela input-output përbën bazën themelore të metodologjisë, e cila mundëson llogaritjen e peshave të kontributit vendas dhe kontributit të importuar. Kjo tabelë përfshin të gjitha transaksionet e realizuara në ekonomi për blerje përfundimtare dhe konsum të ndërmjetëm sipas sektorëve ekonomikë (35 sektorë sipas klasifikimit NACE). Sipas kësaj tabele është e mundur për llogaritja e multiplikatorëve sektorialë të vlerës së shtuar dhe importit (Miller & Blair, 2009). Multiplikatori sektorial i vlerës së shtuar nënkupton kontributin e produktit (shërbimit vendas) për 1 lek kërkesë finale të sektorit. Nga ana tjetër, multiplikatori i importit nënkupton kontributin importues për 1 lek. Për të mundësuar integrimin e statistikave input

output me burimet e tjera statistikore të përdorura në këtë analizë, 35 sektorët e përfshirë janë agreguar në 14 të tillë dhe vlerësimet e multiplikatorëve përkatës raportohen në Grafikon 3.

Grafik 3. Multiplikatorët e vlerës së shtuar dhe të importit sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

Multiplikatorët e paraqitur në Grafikon 3 përbëjnë peshat respektive të produktit (shërbimit) vendas dhe importit që i korrespondojnë ekuacionit 1. Duhet theksuar që multiplikatorët nuk përbëjnë vetëm produktin ose shërbimin vendas ose të huaj për sektorin përkatës. Multiplikatorët përfshijnë edhe vlerë të shtuar ose import të krijuar në sektorë të tjerë të ekonomisë, të cilët ofrojnë inpute për sektorin në analizë. Me fjalë të tjera, ndikimet direkte dhe indirekte (të shpjeguara më sipër) janë të përfshira në multiplikator. Për shembull, ndikimi "karburanteve" si një element i kostos së "Bujqësisë", përfshihet në multiplikatorin e importit për sektorin përkatës.

Nga grafiku i mësipërm vihet re se produkti vendas është mbizotërues në rastin e sektorit të "Bujqësisë", "Industrisë nxjerrëse", "Industrisë së Tekstileve" dhe në rastin e "Shërbimeve". Mbizotërim i lartë i importeve vihet re në rastin e "Industrisë ushqimore", "Produkteve farmaceutike", "Karburanteve", dhe sektorit të "Produkteve prej druri dhe letre". Degët e tjera shfaqin kontribute më të balancuara mes produktit vendas dhe importit.

Pas përcaktimit të peshave, është e domosdoshme prania e serive të çmimeve në terma totalë për sektorin dhe më vete për çmimin

vendas dhe atë të importit. Për përcaktimin e serisë së çmimeve totale, hyjnë në përdorim statistikat e Indeksit të Çmimit të Konsumit të dezagreguara (sipas raportimit të Instat). Meqenëse struktura e shportës konsumatore është në bazë produktesh dhe shërbimesh dhe jo në bazë sektoriale (sikurse tabela input-output), elementet e shportës riagregohen (duke filluar nga niveli më i detajuar) në mënyrë të tillë që të përkojë me strukturën sektoriale të tabelës input-output. Grupimi i elementeve të shportës konsumatore me sektorin korrespondues paraqiten në tabelën e Shtojcës 1.

Për përafrimin e çmimeve të importit, përdoren seritë e dezagreguara të Indeksit të Çmimit të Importeve (INSTAT). Në këtë rast, indekset raportohen me bazë sektoriale sipas strukturës së paraqitur në Grafikon 3. Përdorimi i indekseve të importit dikton zbatimin e supozimit se ofrimi i produktit të importuar qoftë për konsum të ndërmjetëm, qoftë për mallra përfundimtare, realizohet sipas një çmimi të përbashkët. Mungesa e serive të dezagreguara sipas kësaj përjasaje është arsyeja e vendosjes së këtij supozimi.

Statistikat e Indeksit të Çmimit të Importeve nuk përfshijnë dy sektorë të përdorur në analizë: Bujqësinë dhe Shërbimet. Në rastin e shërbimeve, çmimet e huaja përafrohen sipas deflatorit të përgjithshëm të importit të shërbimeve llogaritur në bazë të statistikave të llogarive kombëtare sipas metodës së shpenzimeve. Për sa i përket rastit të Bujqësisë, indeksi i çmimit është llogaritur sipas statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave bujqësore të raportuara në vlerë dhe në sasi.

Elementi i fundit i panjohur në ekuacionin 1 është indeksi i çmimeve të brendshme, i cili llogaritet si mbetje nëse totalit të çmimeve në nivel sektori i zbriten të gjitha elementet e tjera të njohura. Dezagregimi bëhet fillimisht në nivel sektorial dhe më pas, sipas agregimit në nivel të përgjithshëm çmimesh. Në seksionin e mëposhtëm, rezultatet raportohen në terma të kontributeve të brendshme dhe të huaja. Në rastin e kontributeve të importuara, jepen edhe ndikimet direkte dhe indirekte. Në hapin e fundit, paraqitet edhe një dezagregim alternativ i kontributeve të brendshme sipas kontributeve të pastra sektoriale, kontributeve të marzheve tregtare dhe të transportit dhe kontributit të taksave neto.

4. REZULTATET

4.1 Hyrje


Në seksionet e mëposhtme, do të paraqiten rezultatet për kontributet e brendshme dhe të huaja sipas kategorive të mallrave dhe në total për shërbimet sipas kategorizimit të shpjeguar në metodologji. Presionet e huaja inflacioniste janë kategorizuar më tej në kontribute direkte për mallrat dhe shërbimet e importuara që konsumohen dhe ndikime indirekte përmes kanalit të kostos. Në hapin e dytë, rezultatet individuale agregohen në nivel inflacioni të përgjithshëm, në terma të kontributit të përgjithshëm të brendshëm dhe në kontributin e përgjithshëm të importuar.

Presionet e huaja agregohen gjithashtu në terma të totalit të kontributeve direkte dhe indirekte. Presionet e importuara që përçohen përmes kanalit të kostove ndahen gjithashtu në terma të bartësit të kostos (për sektorët që përmes kostos përçojnë presionet e importuara në inflacion) dhe shkaktarit të kostos (për sektorët që ofrojnë inpute të importuara të përdorura nga sektorë të tjerë). Agregimi në terma të përgjithshëm i kontributeve të huaja inflacioniste realizohet edhe sipas parimit të mësipërm. Së fundi, kontributet e brendshme inflacioniste dezagregohen në terma të kontributeve sektoriale, kontributit të marzheve (tregtare dhe të transportit) dhe kontributit të taksave neto (taksa minus subvencionet).

4.2 Bujqësia dhe industria ushqimore

Sikurse përmendet në pjesën metodologjike, sektori i "Bujqësisë" përfaqësohet në shportën konsumatore nga "Ushqimet e papërpunuara" dhe "Drutë e Zjarrit". Nga ana tjetër, "Industria Ushqimore" përfaqësohet nga tërësia e "Ushqimeve të Përpunuara". Më poshtë, paraqiten kontributet e brendshme të importuara për secilin nga sektorët.

Grafik 4. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Bujqësi”




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Me përjashtim të rasteve të rralla, janë presionet e brendshme ato që përcaktojnë dinamikën e inflacioniste në rastin e sektorit “Bujqësor”. Kjo nuk përbën habi duke pasur parasysh peshën e ulët të importeve në këtë kategori dhe mbizotërimin e prodhimit të brendshëm. Këto kontribute janë përgjithësisht të qëndrueshme në kohë.

Një pasqyrë e ndryshme paraqitet në rastin e “Industrië ushqimore”. Në këtë rast, presionet e huaja inflacioniste shfaqen me ndikime më të shpeshta dhe magnitudë më të lartë. Megjithatë, edhe në këtë rast, janë presionet e brendshme inflacioniste ato që janë përcaktuese. Në disa raste, kontributet janë pothuaj simetrike me ndikime të brendshme pozitive dhe të huaja negative. Përjashtim bëjnë tre tremujorët e fundit, ku kontributi i importuar direkt kalon në territor pozitiv.

Grafik 5. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Industri ushqimore”




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

4.3 Sektorë me çmime të rregulluar dhe pjesërisht të rregulluar

Në këtë grupin përfshihen sektori i “Furnizimit me ujë dhe kanalizime”, çmimet e të cilit janë të administruara. Sektori “Energji elektrike-gaz” përfshin dy nënsektore, një prej të cilëve karakterizohet nga çmime të rregulluar (Energjia elektrike) ndërsa tjetri jo (Furnizimi me Gaz). Në rastin e sektorit të produkteve “Farmaceutike”, ekziston prania e çmimeve të rregulluara, por me një frekuencë ndryshimi më të shpeshtë në kohë.


Grafik 6. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Furnizim me ujë dhe kanalizime”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në rastin e “Furnizimi me ujë e kanalizime” (grafiku 6), presionet e importuara mund të ndikojnë vetëm përmes kanalit të kostove, të cilat kompensohen nga ndikimet e brendshme (në formë simetrike). Në vitin 2018 është pasqyruar një rritje (e administruar) e çmimit të furnizimit me ujë që është reflektuar edhe në normën e lartë të inflacionit në këtë drejtim. Në rastin e “Energjisë elektrike dhe gazit” (grafik 7), paraqitet përsëri një profil simetrik i kontributeve. Dallimi është që në këtë rast janë kontributet direkte të importuara forma e pasqyrimin të presioneve të huaja inflacioniste. Gjithashtu, natyra simetrike e kontributeve është më pak e dukshme, ndoshta për shkak të pranisë së “Gazit”.


Grafik 7. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Energji elektrike dhe gaz”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në rastin e produkteve "Farmaceutike" (grafik 8) kujtojmë që këtu përfshihen nënkategori me çmime të administruara, por me variancë më të lartë në kohë. Natyra simetrike e kontributeve është më e fortë në periudhën 2016-2019. Kontributet e importuara shprehen pothuajse tërësisht në formën e ndikimeve direkte dhe kjo është e pritshme, duke pasur parasysh intensitetin e lartë importues në këtë kategori (për mallra përfundimtare). Vihet re një kontribut më i lartë pozitiv i importuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Kjo mund të jetë e lidhur me shtrenjtimin e këtyre produkteve për shkak të pandemisë COVID-19.

Grafik 8. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit të produkteve "Farmaceutike"




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

4.4 Sektorë të tjerë të industrisë përpunuese

Sektorët që do të trajtohen në këtë seksion përfshijnë "Tekstilet dhe veshjet", "Mobiljet", "Makinëritë", "Produktet prej druri dhe letre" (mobiljet janë kategori e veçuar), "Produktet plastike", "Produkte metalike". Në rastin e sektorit të "Tekstileve dhe veshjeve" (grafik 9), vihet re një mbizotërim i kontributeve të brendshme inflacioniste, të cilat vlerësohen negative përgjatë gjithë periudhës në analizë. Përgjatë vitit 2018, ku vërehen kontribute të larta pozitive. Kontributet e importuara raportohen gjithashtu përgjithësisht negative, si në terma direktë ashtu edhe në terma indirektë. Kontribute të lehta pozitive vihen re vetëm gjatë tremujorëve të fundit të analizuar.


Grafik 9. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Tekstile dhe veshje”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në rastin e sektorit të “Mobiljeve” (grafik 10) vihet re gjithashtu një mbizotërim i presioneve të brendshme inflacioniste, të cilat, në shumë raste, shërbejnë si kundërbalancë për ato të huaja. Ky fenomen është veçanërisht i dukshëm në vitet 2018 dhe 2020, kur kontributet e brendshme dhe të huaja paraqiten të alternuara. Kjo mund të nënkuptojë që goditja nga çmimet e huaja absorbohet nga pjesa e brendshme e tregut (mundësisht përmes marzheve tregtare) për të lënë një çmim të pandryshuar për konsumatorin.


Grafik 10. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Mobilje”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në rastin e sektorit të "Makinerve" (grafik 11) vihet re një mbizotërim i presioneve të huaja inflacioniste dhe kjo është pritshme, duke pasur parasysh intensitetin e lartë importues të kategorisë. Në disa tremujorë vihen re edhe ndikime të presioneve të brendshme, por duke pasur parasysh mungesën e një industrie prodhuese, këto ndikime mendohet të jetë të lidhura kryesisht me marzhet e brendshme tregtare. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, presionet e huaja pozitive kanë ardhur në rritje dhe kanë qenë burimi kryesor i formimit të inflacionit.


Grafik 11. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit "Makineri"



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

Për sa i përket sektorit të prodhimeve prej "Druri, letre dhe shërbimeve të printimit" (grafik 12), vihet re prania e kontributeve të brendshme pozitive dhe të huaja negative. Gjatë periudhës 2018-2019, kontributet e brendshme pozitive marrin vlera mjaft të larta, ndërkohë që ato të huaja direkte kalojnë shpesh në territor pozitiv. Kontributet e brendshme zbehen prej 2019T4 dhe qëndrojnë mjaft të ulëta përgjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Kontributet e huaja janë pothuaj inekzistente gjatë kësaj periudhe.


Grafik 12. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit “Dru, letër dhe shërbime printimi”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në rastin e sektorit të produkteve “Plastike” (grafik 13), vihet re prania e presioneve të huaja negative fillimisht përmes kanalit indirekt (gjatë periudhës 2014-2016) dhe më pas e presioneve direkte (2017- 2018). Kontributi indirekt lidhet kryesisht me ecurinë e çmimeve të naftës që përbëjnë një element të rëndësishëm të kostos së këtij sektori. Në të gjitha rastet, vlerësohet prania e kontributeve të brendshme përgjithësisht pozitive me përjashtim të vitit 2015.


Grafik 13. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit të produkteve “Plastike”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Së fundi, në rastin e sektorit të produkteve “Metalike” (grafik 14), kontributet e inflacionit të importuar, si në terma direktë ashtu edhe indirektë, është mbizotërues. Gjatë vitit 2016, vihet re prania e kontributeve të larta pozitive të brendshme në gjendje të balancojnë kontributet e larta negative nga importi. Duke pasur parasysh intensitetin e lartë importues të sektorit, mendohet që kontributet e brendshme janë shprehur edhe përmes dinamikave në marzhet tregtare dhe në taksa neto.

Grafik 14. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit të produkteve “Metalike”




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

4.4 Karburante

Një kategori e rëndësishme, rëndësia e së cilës do të duket në seksionet e mëvonshme (kur flitet për impaktin në terma agregatë), janë karburantet (në këtë rast, bëhet fjalë për karburante të përpunuara dhe jo për naftën bruto që i përket industrisë nxjerrëse). Nga seksioni metodologjik kujtojmë se intensiteti importues është mjaft i lartë në rastin e karburanteve. Impaktet e brendshme janë më tepër të shprehura përmes kanalit të marzheve tregtare dhe të taksave neto që ndikojnë në përçimin e çmimit të huaj në inflacion. Sipas grafikut të mëposhtëm, vlerësohet prania e një kontributi të fortë negativ nga importi në vitet 2014 dhe 2016. Dallimi mes këtyre dy viteve është që, nëse gjatë vitit 2014 presionet e brendshme frenuan përçimin e çmimit të importit në inflacionin

sektorial (inflacioni i përgjithshëm i karburanteve raportohet pozitiv pavarësisht rënies së lartë të çmimit të importit), kjo nuk vihet re në vitin 2016. Rënia e çmimit të importit vlerësohet të jetë reflektuar tërësisht në inflacion dhe kontributet e brendshme vlerësohen në të njëjtin drejtim. Edhe gjatë viteve në vazhdim, inflacioni i kësaj kategorie ka ndjekur më nga afër ecurinë e çmimeve të importit. Ndikimet importuese janë përsëri pozitive në vitet 2018-2019, por zbehen në vazhdimësi dhe veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.

Grafik 15. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit të “Karbuaranteve”



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.


4.5 Shërbimet

Vlerësimet në lidhje me sektorin e shërbimeve nuk paraqiten në nivel të dezagreguar pasi nuk raportohet një statistikë e dezagreguar për deflatorin e importit të shërbimeve (ndryshe nga rasti i mallrave). Gjithashtu, meqë shërbimet konsiderohen si të patregtueshme, shpesh herë presionet e huaja inflacioniste që prekin këtë sektor neglizhohen. Duhet theksuar që në rastin e shërbimeve, si presionet e huaja direkte ashtu edhe ato indirekte janë të pranishme. Në rastin e presioneve direkte, duhet përmendur që importet e shërbimeve në tërësi janë në raportin 14.5% ndaj PBB-së nominale gjatë periudhës në analizë dhe importet e “Shërbimeve personale të udhëtimit” (pjesë e konsumit të popullatës) janë mesatarisht në raportin 8.0% të PBB-së nominale gjatë së njëjtës periudhe. Gjithashtu, tabelat

input-output raportojnë se shërbimet kanë intensitet relativisht të lartë të përdorimit të disa inputeve të importuara (krahasuar me mallrat), në veçanti për sa i përket karburanteve. Si rrjedhojë, vlerësohet që edhe kanali indirekt i kostove mbetet relevant për përcjelljen e presioneve të huaja inflacioniste.

Rezultatet nga grafiku 16 dëshmojnë për praninë e presioneve të importuara negative në formën e kostove të prodhimit. Këto lidhen kryesisht me ecurinë e karburanteve. Gjatë vitit 2014 vihet re edhe një kontribut i lartë pozitiv nga ana e ndikimeve të brendshme inflacioniste. Kujtojmë që gjatë kësaj periudhe, përcimi i çmimit të karburanteve ka rezultuar më i dobët për shkak të presioneve të brendshme që kompensonin ato të huaja dhe kjo është reflektuar gjithashtu në rastin e shërbimeve. Ndërkohë, gjatë vitit 2016, presionet e huaja inflacioniste (përmes kanalit indirekt) kanë dhënë një goditje të fortë në vlerat e ulëta dhe shpesh herë negative të inflacionit të shërbimeve. Presionet e brendshme kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2017-2018 dhe presionet e huaja negative janë zbehur për të kaluar më pas në territor negativ. Rritja e inflacionit të karburanteve është një nga elementet kryesore të importuara në kosto. Viti 2019 është karakterizuar nga kontribute të brendshme në rënie, por të cilat janë rigjallëruar përsëri gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.

Grafik 16. Kontributet e brendshme dhe të importuara (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%) të sektorit të "Shërbimeve"




Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

4.6 Kontributet në nivel të agreguar dhe kontributi i brendshëm

Agregimi i kontributeve sektoriale realizohet duke marrë parasysh peshat që sektorët kanë në tërësinë e shportës konsumatore. Në këtë mënyrë, si kontributet sektoriale të brendshme ashtu edhe ato të importuara (si direkt ashtu edhe indirekte) peshohen për të dhënë ndikimin në inflacionin e përgjithshëm. Rezultatet e agregimit paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 17. Dezagregimi i kontributeve të brendshme dhe të huaja (pp) në inflacionin total (%)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.


Rezultatet dëshmojnë për mbizotërim të presioneve të brendshme inflacioniste përgjatë gjithë horizontit analizues në përputhje me gjetjet nga Skufi dhe Çela (2017). Ndikimet e brendshme kanë ardhur në ngadalësim gjatë vitit 2015 dhe 2016 krahasuar me vlerat në vitin 2014. Gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2016 (kur dhe inflacioni shënonte normat më të ulëta) vihet re edhe një pakësim i ndjeshëm i kontributeve të brendshme inflacioniste. Këto ndikime u rikuperuan gjatë tremujorit të tretë 2016 dhe kanë mbetur relativisht të larta deri në fund të vitit 2018. Në vitin 2019, kontributet e brendshme fillojnë të pakësohen ndjeshëm, duke nxitur edhe norma më të ulëta inflacioni gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, në gjysmën e parë të vitit 2020, kontributet e brendshme fillojnë të ngjiten përsëri, duke reflektuar edhe inflacion të përgjithshëm më të lartë.

Presionet e huaja inflacioniste janë shprehur kryesisht në formën e ndikimeve direkte dhe përgjithësisht negative. Ndikimet indirekte vihen re si gjatë vitit 2014 ashtu edhe gjatë vitit 2016. Sikurse përmendet më parë, dallimi mes këtyre dy viteve ka qenë qëndrueshmëria e presioneve të brendshme inflacioniste në vitin 2014 (për të kompensuar të jashtmet). Gjatë vitit 2019, kontributet e importuara janë pothuaj inekzistente, ndërkohë që shfaqin disa kontribute të lehta pozitive (kryesisht të formës direkte) gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020.

Kontributi i brendshëm i dezagreguar (grafiku 18) dëshmon për mbizotërim të sektorit të "Bujqësisë". Kujtojmë që në këtë sektor është e përfshirë kategoria e "Ushqimeve të papërpunuara", e cila për një kohë të gjatë ka dhënë kontributet kryesore në inflacionin e përgjithshëm (ref. "Raporti i politikës monetare"). Në të njëjtën kohë, vihen re kontribute të rëndësishme edhe nga ana e "Industrisë ushqimore", ku mbizotërojnë "ushqimet e përpunuara". Kontributet e këtyre kategorive kanë ardhur në zbehje gjatë fillimit të vitit 2016 dhe kanë rezultuar një shkak i rëndësishëm në zvogëlimin e vlerave të inflacionit të përgjithshëm. Prej gjysmës së dytë të vitit 2016, kontributet e brendshme të "Industrisë ushqimore" kanë ardhur në rritje, duke nxitur në tërësi kontributet e brendshme. Nga ana tjetër, kontributet e sektorit bujqësor kanë shfaqur oshilacione të mprehta dhe me ndikim të fortë në inflacion. Rënia e këtyre kontributeve gjatë vitit 2019 dhe rritja e tyre gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, përbëjnë një faktor shpjegues të inflacionit në tërësi, gjatë këtyre periudhave.

Një tjetër sektor që ka prodhuar kontribute të rëndësishme dhe me ndikim është ai i "Shërbimeve". Edhe në këtë rast, vihet re një pakësim i qenësishëm i kontributeve përkatëse në vitin 2015 dhe veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Kjo mendohet të jetë e lidhur me kushtet ciklike të ekonomisë, pasi "Shërbimet" karakterizohen nga ndikime përgjithësisht të brendshme direkte. Përmirësimi ciklik ka reflektuar edhe në një zgjerim të kontributeve të brendshme të kësaj kategorie prej gjysmës së dytë të vitit 2016 dhe në vazhdim. Dinamika e kontributit të shërbimeve ka qenë faktor pas ndikimit të fortë të inflacionit të brendshëm në fillim të vitit 2019 dhe zbehjes së tij më pas.

Grafik 18. Kontributet e brendshme në inflacionin total (pp) sipas sektorëve




Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

4.7 Kontributet e inflacionit të importuar

Ndikimi i inflacionit të importuar në inflacionin e përgjithshëm mund të trajtohet sipas disa këndvështrimeve bazuar në kanalet e ndryshme të ndikimit. Impakti fillestar i importit është ai direkt, përmes mallrave dhe shërbimeve të importuara që konsumohen drejtpërdrejtë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet kontributi direkt i inflacionit të importuar në inflacionin e përgjithshëm dhe i dezagreguar sipas sektorëve ekonomikë.

Grafik 19. Kontributi direkt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) në inflacionin e përgjithshëm (pp)




Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

Vlerësohet që kontributi direkt i inflacionit të importuar ka rezultuar negativ përgjatë gjithë periudhës së analizuar, me përjashtim të vitit 2015 dhe gjysmës së parë të vitit 2020. Ndikimi negativ ka qenë veçanërisht i lartë gjatë vitit 2016, ku kontributi zbriti në -0.6 pikë përqindje. Në terma sektorialë, ndikimet kryesore lidhen me kategorinë e "Industriës ushqimore", për shkak të intensitetit të lartë importues të këtij sektori. "Karburantet" kanë luajtur gjithashtu rol të rëndësishëm, veçanërisht gjatë vitit 2016. Rritja e kontributit të importuar direkt gjatë vitit 2020 lidhet kryesisht me kategorinë e "Industriës ushqimore" dhe "Farmaceutikës". Vlerësohet që impakti i pandemisë ka nxitur inflacionin e importuar për këto dy kategori.

Kanali i dytë i transmetimit të impaktit të importuar është përmes kostove të prodhimit. Në këtë rast, kontributet trajtohen në dy aspekte. Aspekti i parë është sipas sektorit bartës të kostos, i cili përdor inpute të importuara dhe si rrjedhojë çmimi përfundimtar i mallit (ose shërbimit) ndikohet nga çmimet e importuara të këtyre inputeve. Kontributet në inflacionin e përgjithshëm sipas kësaj pikëpamjeje paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 20. Kontributi indirekt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve bartës të kostos në inflacionin e përgjithshëm (pp)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.


Në tërësi, kontributi negativ indirekt i inflacionit të importuar vlerësohet më i ulët krahasuar me kontributin direkt. Gjatë periudhës fillestare të analizuar (2014-2016) kontributet janë kryesisht

negative me vlera krahasimisht të larta në vitin 2016. Kontributet pozitive dhe negative alternohen gjatë viteve në vazhdim. Në fillim të vitit 2020, impakti indirekt vlerësohet përsëri negativ dhe me rritje në tremujorin e dytë.

Në terma të dezagreguar, vihet re se impakti indirekt i çmimeve të importit përçohet kryesisht përmes çmimit të shërbimeve. Një gjë e tillë shpjegohet nga intensiteti i lartë i përdorimit të inpueteve të importuara (veçanërisht të karburanteve) nga ky sektor. E njëjta gjë vlen edhe për sektorin e “Industri së ushqimore”. Ndikime negative vihen re edhe në kategori të tjera, por magnitudat janë më të ulëta.

Për të plotësuar tablonë e kanalit të kostove, duhet analizuar edhe impakti indirekt sipas inpueteve të importuara. Në këtë rast, identifikohet kontributi i dezagreguar sipas sektorëve me intensitet të lartë importues dhe që ofrojnë produkte të ndërmjetme që përdoren nga sektorë të tjerë. Kontributet në inflacionin e përgjithshëm sipas kësaj përfaqseje paraqiten në grafikun 21.

Grafik 21. Kontributi indirekt i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve shkaktarë të kosos në inflacionin e përgjithshëm (pp)




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Nga grafiku i mësipërm, vihet re se ndikimet e inflacionit të importuar të kosos përcaktohen në pjesë më të madhe nga dinamika e çmimit të importuar të “Karburanteve”. Ndikimet kanë qenë relativisht të forta në vitet 2014 dhe gjysmën e parë të vitit 2016.

Kështu, në vitin 2014, kontributi i inflacionit të importuar të kostos vlerësohet në -0.1 pikë përqindje dhe kontributi i “Karburanteve” në -0.2 pikë përqindje. Në gjysmën e parë të vitit 2016, kontributi indirekt i importuar vlerësohet në -0.4 pikë përqindje dhe ai i “Karburanteve” në -0.3 pikë përqindje. Nga ana tjetër, periudha 2018-2019T2 pasqyron ndikime krahasimisht të larta pozitive, të cilat vijnë në zbeheje për periudhën e mbetur. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, rënia ndërkombëtare e çmimit të naftës ka nxitur edhe një inflacion më të ulët indirekt në vend (të lidhur me këtë nënkategori). Për analogji me grafikun 20, rënia e çmimit të karburanteve pasqyrohet në rënieën e kontributit indirekt të sektorit të “Shërbimeve”, ku karburantet përbëjnë një element të rëndësishëm të kostos.

Grafik 22. Kontributi i përgjithshëm i inflacionit të importuar (total dhe sipas sektorëve) sipas sektorëve përgjegjës në inflacionin e përgjithshëm (pp)




Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Grafiku 22 paraqet kontributet e përgjithshme të inflacionit të importuar si direkt ashtu edhe indirekt. Vihet re se kontributet kryesore burojnë nga sektorët e “Industrisë ushqimore” (impakt direkt) dhe “Karburanteve” (impakt indirekt). Kontributet veçanërisht të ulta të inflacionit të importuar gjatë vitit 2016 dhe pjesërisht gjatë vitit 2017, lidhen pikërisht me ndikimet e këtyre dy sektorëve. Gjatë vitit 2017, vihet re një kontribut negativ nga pothuaj të gjithë sektorët e përfshirë, duke sugjeruar për praninë e ndikimit të efektit të kursit të këmbimit (kujtojmë edhe njëherë fenomenin mbiçmues të

intensifikuar të monedhës vendase gjatë kësaj periudhe). Në vitin 2020, vlerësohen kontribute pozitive nga “Industria ushqimore”, por negative nga “Karburantet”. Kontributet më të larta pozitive kundrejt atyre negative kanë nxitur edhe kontribut më të lartë të importuar gjatë kësaj periudhe.

Në seksionin që i kushtojmë ndikimeve në nivel sektorial është theksuar për ndikime shpesh në kahe të kundërta. Shpesh herë presionet e huaja inflacioniste nuk përçohen, për shkak të ndikimit të brendshëm që shërben si kundërpeshë. Nga grafiku 21, mund të vihen re ndikime nga sektorë të tillë si “Energjia elektrike dhe gazit” dhe “Furnizimi me ujë”, por kujtojmë që bëhet fjalë për kategori me çmime të administruara (ose pjesërisht të administruara, në rastin e “Energjisë elektrike dhe gazit”). Në këto rrethana, është e nevojshme që kontributet sektoriale të brendshme dhe të importuara të merren të agreguara, në mënyrë që ndikimet e kundërta të eliminojnë njëra-tjetrën. Kontributet e dezagreguara sipas këtij këndvështrimi paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 23. Kontributi sektorial neto (pp) në inflacionin e përgjithshëm (%)



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e autorit.

Nga grafiku i mësipërm, vihet re një ndryshim i rëndësishëm i kontributeve në rastin e vitit 2016, kur u shfaqën normat e ulta të inflacionit të përgjithshëm. Në këtë vit, vihet re një zvogëlim i kontributeve pozitive të kontributit të sektorit “Bujqësi dhe peshkim”, shoqëruar më ndikime të forta negative nga ana e inflacionit të “Karburanteve”. Kujtojmë që në rastin e “Karburanteve”, inflacioni

i importuar ka shfaqur rregullisht vlera negative, por përcimi i tyre ka qenë mjaft i fortë në vitin 2016 (grafiku 14). Gjatë të njëjtës periudhe, vihet re një pakësim i kontributit të "Industrisë ushqimore" dhe sektorit të "Shërbimeve". Në rastin e "Industrisë ushqimore", fenomeni lidhet në pjesë më të madhe me kontributet e brendshme inflacioniste (grafiku 5) dhe e njëjta gjë vlen edhe për sektorin e "Shërbimeve" (grafiku 16).

Prej tremujorit të tretë të vitit 2016, normat e inflacionit kanë rezultuar më të larta. Kontributet në rritje kanë buruar nga "Industria ushqimore" dhe sektori i "Shërbimeve". Në të dy rastet, kanë qenë kontributet rritëse të brendshme ato që kanë dhënë ndikim kryesor. Në rastin e "Karburanteve", vihet re një ndikim i ndryshëm i kontributeve të importuara. Inflacioni i importuar i kategorisë ka kaluar në vlera pozitive prej tremujorit të katërt të vitit 2016, duke arritur vlera të larta gjatë vitit 2018. Sikurse është përmendur, përcimi i çmimeve të huaja të karburanteve në inflacion ka qenë më i fortë gjatë kësaj periudhe (veçanërisht krahasuar me vitin 2014).

Së fundi, presionet e brendshme inflacioniste mbeten kontribuuesi kryesor përgjatë periudhës së analizuar. Këto presione kanë rezultuar në rritje gjatë vitit 2017 dhe përsëri gjatë vitit 2018, megjithëse më të ulëta krahasuar me vitin 2017. Kjo mungesë e inflacionit të brendshëm është kompensuar me inflacionin e importuar. Kontributet e këtij të fundit janë më të larta në vitin 2018 krahasuar me vitin e mëparshëm. Ky kombinim ka bërë që norma e inflacionit në vitet 2017 dhe 2018 të jetë e njëjtë. Rënia e inflacionit të brendshëm, shkaktuar nga sektorët e "Bujqësisë" dhe "Shërbimeve", ka tërhequr për poshtë edhe normën e përgjithshme të inflacionit. Nga ana tjetër, përsëri këta sektorë, të ndihmuar edhe nga kontributet në rritje të inflacionit të importuar të "Industrisë ushqimore", janë përgjegjës për normat më të larta inflacioniste gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.

4.8 Një dekompozim alternativ i presioneve të brendshme inflacioniste

Në këtë seksion do të analizohen presionet e brendshme inflacioniste sipas një përqasjeje të ndryshme. Kujtojmë nga seksioni i shpjegimit të metodologjisë që presionet e brendshme inflacioniste

ndahen në tre komponentë çmimformues. Fillimisht, janë presionet inflacioniste me natyrë sektoriale që burojnë nga vendimmarrja e sektorëve ofrues të mallrave dhe shërbimeve, në lidhje me kostot e faktorëve të prodhimit dhe marzhet e fitimit. Komponenti i dytë lidhet me marzhet tregtare dhe të transportit, që kanë të bëjnë me procesin e zhvendosjes së mallit (dhe për kategori të caktuara të shërbimeve) nga ofruesi te konsumatori. Së treti, është elementi i taksave neto indirekte (taksa minus subvencione) mbi produktet dhe shërbimet. Të treja këto elemente janë me natyrë tërësisht të brendshme, por logjika e përcaktimit dhe dinamikat ndryshojnë nga një rast në tjetrin dhe përgjatë horizontit kohor. Dezagregimi i këtyre efekteve është i rëndësishëm për njohjen më të mirë të natyrës së presioneve të brendshme inflacioniste dhe përpilimin e politikave reaguese.

Realizimi i dezagregimit të presioneve të brendshme inflacioniste sipas përqasjes së shpjeguar do të realizohet në nivel të përgjithshëm (jo në nivel sektorial) dhe bazohet në strukturën e Tabelës së Burimeve, të cilat identifikojnë vlerën nominale të “Marzheve tregtare dhe të transportit” dhe “Taksave neto” për secilin sektor të përfshirë. Kjo mundëson llogaritjen e peshës së këtyre dy kontributeve në vlerën e produktit të ofruar në treg sipas secilit sektor. Ndikimet në nivel sektori peshohen sipas kontributeve që secili sektor ka në shportën konsumatore për të përfutur peshën e këtyre dy komponentëve në konsum. Peshat sipas viteve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Pesha e “Marzheve tregtare dhe të transportit” dhe “Taksave neto” në shportën konsumatore në përqindje

Viti	Marzhi tregtar dhe i transportit	Taksa neto
2014	13.1	6.5
2015	13.1	6.5
2016	12.6	6.7
2017	11.1	6.1
2018	11.1	6.1
2019	11.1	6.1
2020	11.1	6.1

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Për të llogaritur kontributet në inflacion, përveç peshës në shportën konsumatore, nevojitet edhe një seri çmimesh për secilin nga dy komponentët. Në këtë rast, çmimi duhet të reflektojë ndikime

tërësisht të brendshme dhe treguesi më i përshtatshëm është deflatori i vlerës së shtuar sipas llogarive kombëtare. Në rastin e taksave neto, deflatori është një tregues i vetëm. Ndërkohë, marzhi tregtar dhe i transportit përbëhet nga disa komponentë dhe kjo përbërje buron gjithashtu nga Tabela e Burimeve.


Tabela 2: Marzhi tregtar dhe i transportit sipas komponentëve përbërës (% nga totalit)

Sektori	Pesha ndaj totalit të marzhit
Tregti me shumicë	43.6
Tregti me pakicë	29.4
Transport tokësor dhe me tubacione	15.4
Riparim i automjeteve dhe motoçikletave	8.7
Transport ujor, ajror dhe magazinim	3.0

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit

Për të llogaritur indeksin e çmimit të marzhit, deflatorët e vlerës së shtuar bruto sektoriale peshohen sipas strukturës së tabelës 2. Deflatorët më pas peshohen sipas përpjesës së marzhit tregtar dhe të transportit në shportën konsumatore (Tabela 1) për të përfutur kontributin në inflacion. Vlerësimet sipas kësaj përfaqseje realizohen në tërësi dhe jo sipas sektorëve ekonomikë, për shkak të pranisë së serive të përgjithshme të deflatorëve të vlerës së shtuar bruto për kategoritë përbërëse. Kontributi i sektorëve të ekonomisë llogaritet si mbetje pas zbritjes së kontributeve të marzhit dhe taksave neto nga totali. Kontributet e dezagreguar paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 24. Kontributi i brendshëm i dezagreguar (pp) në total



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.


Sipas grafikut të mësipërm, kontributet sektoriale kanë qenë përgjithësisht përcaktuese të presioneve të brendshme inflacioniste. Kontributet mesatare vjetore të kësaj kategorie kanë ardhur në rënie të lehtë gjatë periudhës 2015-2017. Kështu, kontributi sektorial në inflacion vlerësohet 2.3 pikë përqindje në vitin 2015, për të rënë në 1.9 pikë përqindje në vitin 2016 dhe 1.7 pikë përqindje në vitin 2017. Veçanërisht i ulët vlerësohet ky kontribut në tremujorin e parë të vitit 2016, kur ra në 1.2 pikë përqindje krahasuar me 2.4 pikë përqindje një tremujor më parë. Gjatë këtij tremujori, kontributi i brendshëm u pakësua nga 2.2 pikë përqindje në 1.8 pikë përqindje. Rënia e kontributit të brendshëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2016 mund të kishte rezultuar edhe më e lartë nëse nuk do të materializohej një kontribut pozitiv nga taksat neto.

Nga tremujori i katërt 2016 deri në fund të vitit 2017, vihet re një kontribut në rritjen e presioneve të brendshme inflacioniste. Grafiku 24 sugjeron një impakt të rëndësishëm nga marzhet tregtare dhe të transportit dhe të taksave neto. Këto kontribute kanë vazhduar të jenë të pranishme edhe përgjatë vitit 2019, duke kompensuar për kontribute sektoriale lehtësisht më të ulëta. Gjysma e parë e vitit 2020 pasqyron një përmbysje të fenomenit. Kontributet sektoriale fillojnë të rriten përsëri, ndërkohë që kontributi i taksave kalon në territor negativ. Për sa i përket marzheve tregtare, vlerat vijjnë drejt zbehjes.

HAPËSIRË INFORMUESE: INFLACIONI NË KOHËN E PANDEMISË COVID-19

Gjysma e parë e vitit 2020 është karakterizuar nga norma më të larta inflacioniste krahasuar me periudhën e mëparshme. Inflacioni shënon vlerën 1.8% gjatë kësaj periudhe, nga 1.3% për gjysmën e dytë të vitit 2019 dhe 1.4% për gjithë vitin 2019. Vlerësohet që kontributet kanë qenë në rritje si nga sektori i brendshëm ashtu edhe nga inflacioni i importuar. Në veçanti, kontributet e brendshme janë dukshëm më të larta krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2019, me një rritje mesatare prej rreth 0.4 pikësh përqindjeje. Kontributet e importuara janë lehtësisht më të larta, kryesisht e lidhur kjo me impaktin direkt.

Grafik 25. Kontributi i brendshëm dhe i huaj (pp) në inflacion (%)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Rritja e kontributit të brendshëm buron kryesisht nga sektorët e "Bujqësisë" dhe "Shërbimeve". Ndërkohë, rritja e kontributit të importuar direkt lidhet me kategorinë e "Industriës ushqimore". Të gjitha kategoritë e përmendura vlerësohet të kenë pasur efekte nga kahu i ofertës që mund të kenë shkaktuar rritje të normave inflacioniste. Ndërkohë, rënia e kontributit indirekt të kostos lidhet me rënien e çmimit të "karburanteve", i cili nga importi është pasqyruar në çmimet vendase. Së fundi, dekompozimi alternativ i presioneve të brendshme sugjerojnë praninë e kontributeve me burim sektorial, në kushtet kur nuk vihet re një rritje e marzheve tregtare dhe kur kontributet e taksave paraqiten negative. Në përfundim, vlerësohet që ndikimet nga oferta kanë qenë përcaktuese në ecurinë inflacioniste, të paktën në periudhën fillestare të pandemisë.

5. PËRFUNDIME

Vlerësimi i disagreguar i presioneve të brendshme dhe të huaja inflacioniste mbështet mbizotërimin e presioneve të brendshme ndaj atyre të huaja gjatë gjithë periudhës së analizuar (në përputhje edhe me studime të mëparshme). Përgjithësisht, vihet re një zbehje e kontributeve të brendshme gjatë vitit 2015 dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, që ka përkuar edhe me shifra më të ulëta të inflacionit të përgjithshëm gjatë kësaj periudhe. Prej gjysmës së dytë të vitit 2016 dhe në vazhdim, presionet e brendshme janë rëkuperuar dhe kanë nxitur norma më të larta inflacioni.

Presionet e huaja inflacioniste, megjithëse jo mbizotëruese në terma të nivelit të kontributeve, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të përcaktimit të dinamikave të inflacionit në momente të caktuara. Veçanërisht, gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, vihet re një kontribut i qenësishëm negativ i këtyre presioneve që ka nxitur vlerat mjaft të ulëta të inflacionit në përgjithësi. Në mënyrë të veçantë, duhet përmendur kontributi i "Karburanteve" si një kanal i rëndësishëm i përcimit të presioneve të huaja në terma direktë.

Për t'u theksuar është prania e presioneve të huaja jo vetëm përmes kanalit direkt, por edhe përmes kanalit indirekt të kostove. Edhe në këtë rast, rëndësia e "Karburanteve" është themelore, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sektori në koston e prodhimit në ekonomi. Ndikimi i kësaj kategorie nuk vihet re vetëm në rastin e mallrave, por është mjaft i fortë edhe në rastin e "Shërbimeve".

Analiza dëshmon për asimetri kohore në terma të përcimit të presioneve të huaja inflacioniste. Normat negative të inflacionit të importuar dhe veçanërisht atij të "Karburanteve" janë vënë re dhe gjatë viteve 2014-2015, por përcimi i plotë i këtyre presioneve është penguar nga ndikimet e brendshme. Në gjysmën e parë të vitit 2016, rënia e çmimit të "Karburanteve" është përcuar më fort në drejtim të çmimit të tregut, duke nxitur edhe një ndikim më të madh në inflacionin e përgjithshëm. Duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2016, presionet e huaja negative inflacioniste janë zbutur disi dhe, në rastin e "Karburanteve", është vënë re një kalim i deflatorëve

vjetorë në territor pozitiv. Megjithatë, kontributet mbeten negative dhe me bazë të gjerë, duke sugjeruar për praninë e ndikimit të efektit mbiçmues të kursit të këmbimit në çmime. Balancimi i ofruar nga presionet e brendshme ka shmangur disi përçimin e këtij efekti në çmimet përfundimtare.

Në lidhje me presionet e brendshme inflacioniste, theksuam se vlerësohet të këtë ndodhur një ringritje e tyre veçanërisht gjatë vitit 2017 dhe në tremujorin e parë të vitit 2018. Një ndikim i rëndësishëm në këtë drejtim ka buruar nga "marzhet tregtare dhe të transportit" dhe "taksat neto". Në tremujorin e parë të vitit 2018, vihet re një kontribut sektorial në rritje, por një pjesë buron nga rritja e çmimit të ujit të pijshëm (artificiale) gjatë kësaj periudhe. Për periudhën e mbetur të analizës, vihen re presione të brendshme sektoriale të moderuara gjatë vitit 2019 dhe me një rritje të shpejtë në dy tremujorët e parë të vitit 2020. Në rastin e fundit, vlerësohet që fenomeni lidhet me impaktin e pandemisë.

6. DISKUTIME, IMPLIKIME DHE MUNDËSI KËRKIMORE NË TË ARDHMEN

Rezultatet mbështesin përfundime në punime të mëparshme (Skufi dhe Çela, 2017) mbi mbizotërimin e presioneve të brendshme inflacioniste në formimin e përgjithshëm të inflacionit në vend. Dimensionin e ri i ofruar në këtë material është përfshirja e kanaleve indirekte të kostos veç impaktit të drejtpërdrejtë. Edhe nëse merret parasysh ky impakt, presionet e brendshme janë përsëri mbizotëruese.

Presionet e huaja inflacioniste kanë përcaktuar dinamikën inflacioniste në disa raste. Në veçanti paraqitet rasti i gjysmës së parë të vitit 2016, kur presionet e huaja veçanërisht të lidhura me çmimet e "Karburanteve", tërhoqën dukshëm për poshtë inflacionin e përgjithshëm. Presionet e huaja negative të lidhura me çmimet e "Karburanteve" u zëvendësuan shpejt me presione të moderuara dhe pozitive. Nga ana tjetër, edhe gjatë periudhës së mbetur, presionet e importuara vlerësohen negative në masë të gjerë, duke sugjeruar për efekte të lidhura me mbiçmimin e monedhës vendase.

Një element i rëndësishëm që ka përcaktuar rëndësinë e presioneve të huaja inflacioniste lidhet me natyrën josimetrike në kohë të përçimit të efekteve në çmimet vendase. Deflatorët e çmimeve të huaja kanë rezultuar negative përgjatë gjithë periudhës së analizuar, por ndikimi i tyre ka qenë më i lartë gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 pikërisht sepse përçimi ka qenë më i fortë gjatë kësaj periudhe. Kjo lidhet edhe njëherë me ecurinë dhe përçimin e çmimit të "Karburanteve". Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, presionet e huaja kanë diktuar pothuajse tërësisht zhvillimet inflacioniste të kësaj kategorie, ndërkohë që para këtij viti presionet e huaja negative inflacioniste janë balancuar nga trysnitë e brendshme. Në çdo rast, ndikimet e presioneve inflacioniste duken ngushtësisht të lidhura me çmimet e "Karburanteve", gjithmonë nëse ndodh një përçim i mirë i këtyre të fundit. Këto presione përbëjnë një element tepër të rëndësishëm në kontributet inflacioniste (për shkak të efektit direkt dhe indirekt) dhe për këtë arsye duhen mbajtur vazhdimisht në vëzhgim, si në terma të ecurisë ashtu edhe në terma të burimit të kontributit.

Përfundimet e këtij materiali ofrojnë edhe disa implikime të rëndësishme për sa i përket analizës së zhvillimeve inflacioniste. Së pari, vlerësohet që nuk ekzistojnë degë me ndikime tërësisht të brendshme ose tërësisht të jashtme. Sikurse u raportua, ndikimet e importit mund të prekin sektorë që përgjithësisht karakterizohen si të brendshëm. Vlen për t'u përmendur këtu rasti i shërbimeve, kur ndikimi i çmimit të inputeve të importuara (veçanërisht të "Karburanteve"), gjeneron ndikime të rëndësishme indirekte në inflacionin e sektorit dhe atë tërësor. Në të njëjtën kohë, prania e marzheve të brendshme tregtare dhe të transportit, ekzistenca e taksave dhe subvencioneve mbi produktet, dhe mundësia e çmimeve të administruara, mund të prodhojnë ndikime të brendshme inflacioniste edhe në sektorë ku mbizotëron produkti i importuar. Këtu mund të përmenden "Karburantet", "Industria ushqimore", "Produktet Farmaceutike", "Makineritë e pajisjet" etj.

Një element i rëndësishëm që konstatohet në këtë analizë lidhet me ndikimin e "marzheve" dhe "taksave neto" në inflacion. Sikurse përmendet në pjesën e rezultateve, ndikimet e këtyre dy kategorive kanë qenë faktor pas ringritjes relative të normave inflacioniste gjatë vitit 2017 dhe pas rënies së moderuar të normave të inflacionit në vitet 2018-2019. Megjithatë këto janë zhvillime kryesisht të brendshme, mund të keqinterpretohen si pasqyrime të zhvillimeve ciklike në ekonomi (përmirësim ose përkeqësim i ciklit), kur në të vërtetë përbëjnë një fenomen të veçantë dhe shpesh jopermanent. Në këtë mënyrë, njohja e këtyre fenomeneve do të shmangte reagime të pasakta të politikës monetare.

Natyra asimetrike e përcimit të goditjeve përbën një tjetër kontribut të analizës në fjalë. Shpesh herë, kontributet që mund të vijnë nga kategori të caktuara të inflacionit, modelohen si konstante nga një periudhë në tjetrën, kur realiteti është i ndryshëm. Për këtë arsye, analiza e përgjithshme e inflacionit përmes modeleve të gjera, duhet të shoqërohet në çdo rast nga një analizë e mikro-inflacionit, për të parë nëse kategori të caktuara paraqesin një sjellje ndryshe. Vlen për t'u përmendur këtu rasti i karburanteve. Sikurse u paraqit në rezultate, inflacioni i importuar i "karburanteve" kishte vlera të ngjashme negative si në vitin 2014 ashtu edhe në vitin 2016. Por ndikimet në

inflacion ishin të pranishme në vitin e dytë, për shkak të natyrës asimetrike të përçimit. Njohja e këtyre zhvillimeve në mënyrë të veçantë dhe rast pas rasti, do të mundësonte një kuptim më të plotë të episodeve të caktuara me inflacion të lartë ose të ulët. Analiza do të ishte edhe më e dobishme në kushtet kur mund të jetë një element i kostos ai që jep një ndikim rritës ose pakësues në disa nëngrupe të inflacionit.

Në kuadër të mundësive kërkimore në të ardhmen, vlen të përmenden disa mangësi të këtij studimi që mund të korrigjohen edhe në kuadër të disponueshmërisë së statistikave më të plota. Së pari, në vlerësimet analitike supozohet që ndikimi i kontributeve të huaja inflacioniste ndodh në kohë reale. Kjo mund të jetë e vërtetë në rastin e shërbimeve, por në rastin e mallrave, shpesh ekzistojnë hapësira kohore mes çastit të importit dhe çastit kur malli ofrohet në treg. Kjo vlen si për mallin përfundimtar ashtu edhe për blerjet për konsum të ndërmjetëm. Prania e vonesave kohore në tërësi dhe sipas sektorëve ekonomikë përbën një fushë për t'u marrë në konsideratë në studime të ardhshme.

Së dyti, në rastin e presioneve të huaja inflacioniste, është me interes ndarja e efektit të çmimeve ndërkombëtare nga kursi i këmbimit. Në rastin e Shqipërisë, kjo përbën interes të veçantë, duke pasur parasysh tendencën e gjatë mbiçmuese që ka karakterizuar monedhën vendase. Pavarësisht faktit që një veprimtari e tillë kërkon një punë të gjerë përllogaritëse, përfshirë këtu identifikimin e monedhave të huaja, në cilat zhvillohet tregtia sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve dhe konvertimi individual, përsëri do të ishte një zhvillim interesant kërkimor në të ardhmen.

Së treti, një tjetër aspekt i rëndësishëm do të ishte dezagregimi i presioneve të brendshme inflacioniste në elemente direkte dhe indirekte. Vlerësohet që kategori të caktuara të çmimeve (në veçanti ushqimet) karakterizohen nga goditje të shpeshta të lidhura me kushte atmosferike, konsiderata të konvergjitimit me çmime të huaja dhe elemente të tjera të kërkesës dhe ofertës. Analiza sipas kësaj përqsasjeje do të hidhte edhe më tepër dritë në lidhje me natyrën e presioneve të brendshme inflacioniste.

Disa përmirësime lidhen edhe me praninë e statistikave më të detajuara në të ardhmen. Platforma analitike është ndërtuar mbi bazën e katër burimeve statistikore: tabelat input-output, statistikat e çmimeve sipas Indeksit të Çmimit të Konsumit, Indekset e Çmimeve të Importit dhe llogaritë kombëtare të Produktit të Brendshëm Bruto (për deflatorët e përgjithshëm të shërbimeve). Megjithëse këto statistika përpilohen nga i njëjti institucion, prania e divergjencave metodologjike (në veçanti për sa i përket indeksit të çmimeve të konsumit) mund të krijojë probleme kur agregohen në një strukturë të përbashkët. Prania e tabelave input-output me çmime konstante (në terma nominalë), do të mundësonte vlerësime më të saktë për produktin e ndërmjetëm. Gjithashtu, prania në të ardhmen e tabelave të veçanta për produktin vendas dhe importet, do të shmangte nevojën e përdorimit të multiplikatorëve sektorialë për llogaritjen e peshave vendase dhe të huaja. Në vend të kësaj, llogaritjet do të mund të realizoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë tek dy tabelat individuale dhe më pas të agregoheshin.

Së fundi, rezultatet nxjerrin në pah fenomene të caktuara të formimit të çmimeve, përfshirë këtu përçimet jolineare në kohë, efektet e marzheve dhe kontributet e taksave-neto. Informacioni sasior në lidhje me shkaqet e ekzistencave të këtyre efekteve është mjaft i kufizuar, por njohja e shkaqeve është thelbësore për të njohur më mirë edhe burimet e presioneve inflacioniste (veçanërisht atyre të brendshme). Në këtë rast lind nevoja e platformave me natyrë më tepër cilësore për marrjen e informacionit. Këtu mund të përmenden vërtetimet e tregut dhe në veçanti të sektorit tregtar dhe të transportit, ku marzhet formohen. Një tjetër element lidhet me taksat neto. Mendohet që taksat ndikojnë jo vetëm në rastet e ndryshimit të normave, por, në rastin e Shqipërisë, edhe në kushtet e ndryshimit të performancës grumbulluese. Të gjitha këto elemente duhet të përfshihen në analizat dhe punën e ardhshme kërkimore që lidhet me inflacionin, për të kuptuar më mirë burimet dhe shkaqet e formimit të çmimeve në vend.

BIBLIOGRAFI

Ahn, J., Park, C.-G., & Chanh, P. (2016). *Pass-Through of Imported Input Prices to Domestic Producer Prices: Evidence from Sector-Level Data*. IMF Working paper WP/16/23.

Ajakaiye, D. O., & Ojowu, O. (1994). *Relative price effects of exchange rate depreciation in Nigeria under fixed and fixed/flexible mark-up pricing regimes*. *World Development*, 22(8), 1175- 1182.

Auer, R. A., Levchenko, A. A., & Saure, P. (2017). *International Inflation Spillovers Through Input Linkages*. NBER Working Paper No. 23246.

Bernanke, B. (2007). *Globalization and Monetary Policy*. Speech at the Fourth Economic. Stanford Institute for Economic Policy Research.

Carluccio, J., Gautier, E., & Guilloux-Nefussi, S. (2018). *Dissecting the impact of imports from low- wage countries on French consumer prices*. Bank of France Working Paper Nr. 672.

Çela, E. (2016). *Transmetimi i çmimeve të importit të çmimet e prodhimit në rastin e Shqipërisë*.

Revista Ekonomike e Bankës së Shqipërisë, 2016 6M-2, pp. 28-40.

Çeliku, E. (2003). *Kontributi i inflacioneve të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në inflacionin total: rasti i Shqipërisë*. *Material diskutimi i Bankës së Shqipërisë*, nr. 1 (12) 03.

Çeliku, E., Çela, E., & Metani, I. (2018). *Prodhimi dhe rritja potenciale, hendeku i prodhimit dhe i papunësisë në Shqipëri: analizë krahasuese e vlerësime të reja, 2015*. *Material diskutimi i Bankës së Shqipërisë*, nr. 30 (69) 18.

Gunluk-Senesen, G., Kaya, T., & Senesen, U. (2018). *Promoting investment in the Turkish construction sector: a structural path analysis*. *Economic Systems Research*, 30(3), 422-438.

Hara, N., Hiraki, K., & Ichise, Y. (2015). *Changing Exchange Rate pass-through in Japan: Does it indicate changing pricing behavior?* Bank of Japan Working Paper Series, No.15-E-4.

Hoang, H. L., & Kiyotaka, S. (2016). *Exchange Rate Pass-through in Production Chains: Application of input-output analysis*. RIETI Discussion Paper Series 16-E-034.

Leontief, W. (1936). *Quantitative Input and Output relations in the Economic System of the United States. The review of Economic and Statistics*, 18, 105-125.

Levy, S. (1985). *A mark-up pricing model for price simulations*. *Journal of Development Economics*, 19, 299-320.

McCarthy, J. (2000). *Pass-Through of Exchange Rates and Import Prices to Domestic Inflation in Some Industrialized Economies*. FRB of New York Staff Report No. 111.

Nordhau, W., & Shoven, J. (1977). *Analysis of Inflation 1965-1974*. In *A technique for Analyzing and Decomposing Inflation* (pp. 333-360). doi:ISBN 0-884-10477-X

Skufi, L., & Çela, E. (2017). *Inflacioni i importuar i mallrave të konsumit dhe kontributi i tij në inflacionin e përgjithshëm*. *Material diskutimi i Bankës së Shqipërisë*, nr. 28 (67) 17.

Sharify, N. (2012). *A Modification in the Input-Output Price Model to Analyse the Effect of Exchange Rate Variation on Prices Indices*. *The 20th International Input-Output Conference and the 2nd Edition of the International School of Input-Output Analysis*, June 24-29, 2012. Bratislava, Slovakia.

Sharify, N., & Sancho, F. (2011). *A new approach for the input-output price model*. *Economic Modelling*, 28, 188-195.

SHTOJCA 1: GRUPIMET SEKTORIALE SIPAS STRUKTURËS INPUT-OUTPUT DHE INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Sektori sipas Input-Output	Ekivalenti në shportën e IÇK-së
Produkte bujqësore, pyjore dhe të peshkimit	<ul style="list-style-type: none"> • Ushqime të papërpunuara • Dru zjarri • Kopshte, bimë dhe lule • Kafshë shtëpiake
Produkte ushqimore, piqe dhe produkte të duhanit	<ul style="list-style-type: none"> • Ushqime të përpunuara
Tekstile, veshje dhe produkte prej lëkure	<ul style="list-style-type: none"> • Veshje dhe këpucë • Tapete • Tekstile shtëpie
Produkte prej druri dhe letre	<ul style="list-style-type: none"> • Gazeta, libra dhe mjete shkollore
Karburante të përpunuara	<ul style="list-style-type: none"> • Karburante dhe lubrifikantë për mjete personale transporti
Produkte kimike, produkte farmaceutike dhe preparate farmaceutike	<ul style="list-style-type: none"> • Mallra konsumi jo të qëndrueshëm • Produkte farmaceutike • Produkte të tjera mjekësore
Produkte prej gome dhe plastike dhe produkte të tjera minerale jometalike	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisje të tjera, artikuj dhe produkte për kujdesin personal • Produkte personale • Artikuj të tjerë personalë
Materiale ndërtimi dhe produkte me bazë metalike	<ul style="list-style-type: none"> • Materiale për mirëmbajtjen dhe riparimin e banesave • Qelqurina, orëdit dhe mjete të tjera shtëpiake • Mjete të vogla dhe aksesorë të ndryshëm • Argjendari, orë dhe ora dore
Makineri, pajisje, mjete transporti dhe pjesë të tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisje të mëdha shtëpiake elektrike ose jo • Pajisje të vogla elektrike shtëpiake • Mjete dhe pajisje të mëdha • Mjete dhe pajisje terapeutike • Makina • Motoçikleta • Biçikleta • Pjesë këmbimi dhe aksesorë për mjete personale transporti • Pajisje telefoni dhe telefaksi • Pajisje recepsioni, regjistrimi dhe riprodhimi të zërit dhe figurës • Pajisje fotografike • Pajisje informatike • Instrumente muzikore dhe mallra të qëndrueshme për argëtim • Lojëra • Pajisje sportive • Pajisje elektrike për kujdes personal
Mobilje	<ul style="list-style-type: none"> • Mobilje dhe mobilime
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar	<ul style="list-style-type: none"> • Pagesa për dritat • Karburante (bombola gazi)

Shërbime të prodhimit dhe furnizimit me ujë dhe shërbime të kanalizimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Pagesa e ujit të pijshëm • Pagesa e ujit për kanalizimet
Shërbime të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Gjithë kategoritë e shërbimeve

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Çela, Enian

Një përfaqëse alternative për dekompozimin e inflacionit në Shqipëri, në kontribute të brendshme dhe të jashtme nga matrica input-output / Enian Çela. – Tiranë :

Banka e Shqipërisë, 2022

... f. ; ... cm. – (Material studimor ; 2 (83))

ISBN 978-9928-262-54-7

1.Banka e Shqipërisë 2.Inflacioni (Financë)
3.Politika monetare 4.Shqipëri

336.711(496.5)

336.748.12(496.5)

www.bankofalbania.org

ISBN 978-9928-262-54-7



9 789928 262547